




MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES

KOMUNA E DRENASIT dhe

RRJETI BALLKANIK PËR GAZETARI HULUMTUESE



Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Norwegian Embassy

Palët nënshkruese

1. Komuna e Drenasit, me adresë, Objekti i Komunës së Drenasit, rruga “Fehmi dhe Xhevë Lladrovci”, 13000, Drenas, e përfaqësuar nga z.Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës

2. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, BIRN Kosova, me adresë në rrugën “Afrim Zhitia Nr.7” Prishtinë 10000, Kosovë, e përfaqësuar nga znj. Jeta Xharra, drejtore ekzekutive e BIRN

Në kontekst të projektit për Auditim Social, Komuna e Drenasit dhe organizata jo-qeveritare BIRN Kosova, merren vesh sipas pikave në vijim:

Neni 1

Baza ligjore

Bazuar në nenin 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale rregulloret e brendshme të komunës dhe statutin e OJQ BIRN, palët dakordohen që në mirëbesim të implementojnë zotimet e dakorduara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Neni 2

Qëllimi

Me qëllim të rritjes së angazhimit të qytetarëve, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal në implementimin e projekteve infrastrukturore dhe mbikëqyrjes qytetare, dhe promovimit të hapësirës së dialogut publik, palët dakordohen t’i hapin rrugë themelimit të “Ekipit të Auditimit Social” në projektin *“Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit - Projekt dy vjeçar”*

Neni 3

Obligimet e BIRN

1. Bazuar në metodologjinë e dakorduar, OJQ BIRN Kosova do të përzgjedhë ekipin multidisiplinar të Auditimit Social në Komunën e Drenasit
 - 1.1. Me qëllim të rritjes së kapaciteteve, BIRN Kosova do të ofrojë një program trajnimi për qytetarët që do të jenë pjesë e ekipit të Auditimit Social;
 - 1.2. Me qëllim të garantimit të një procesi profesional të Auditimit Social, BIRN Kosova do të fasilitojë gjithë procesin përmes ofrimit të mentorimit profesional dhe asistencës teknike për ekipin e themeluar;
 - 1.3. BIRN Kosova do të shërbejë si lehtësues i komunikimit në mes komunës dhe ekipit të Auditimit Social me qëllim të koordinimit dhe dokumentimit të aktiviteteve të grupit;
 - 1.4. BIRN Kosova do të ofrojë asistencë për ekipin e Auditimit Social me qëllim përgatitjen e raportit final dhe raporteve të tjera gjatë procesit për Komunën e Drenasit.



- 1.5. BIRN Kosova do të sigurohet që materialet e mbledhura nga procesi i Auditimit Social të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Obligimet e komunës

1. Komuna e Drenasit ka për obligim të:

- 2.1. Sigurojë qasje në dokumentacionet e nevojshme për të kryer procesin e “Auditimit Social”;
- 2.2. Ofrojë mundësi që pjesëtarët e Auditimit Social të takojnë zyrtarët përgjegjës të përfshirë në implementimin e projektit në fjalë;
- 2.3. Sigurojë qasje të papenguar në hapësirat e realizimit të projektit të auditimit social.

Neni 4

Mbështetja financiare

Mbështetja që ofrohet nga BIRN Kosova përgjatë tërë procesit të Auditimit Social mbulohet nga mbështetja e projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS), projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra, Suedia dhe Norvegjia, zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation-Kosovo.

Neni 5

Mbikëqyrja e realizimit të marrëveshjes

Organ përgjegjës për mbikëqyrjen dhe realizimin e kësaj Marrëveshje është Komuna e Drenasit.

Neni 8


Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje është hartuar në tri (3) kopje origjinale, dhe secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje.
2. Periudha e implementimit të Auditimi Social, gjatë të cilit është i nevojshëm bashkëpunimi që është subjekt i kësaj marrëveshje, zgjatë nga muaji qershor 2023 deri në janar 2024.



Kreshnik Gashi
Redaktor menaxhues, BIRN

Drenas, dt. 12/07/2023



Ramiz Lladrovci
Kryetar, Komuna Drenas

Drenas, dt. 14/07/2023